



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 21 JANAR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 17:00)

Rendi i ditës:

1. Hapja e Sesionit IV të Legjislaturës IX të Kuvendit të Shqipërisë
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 20.12.2018, 21.12.2018 dhe 16.01.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*
3. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*
4. Miratimi i programit 6-javor të punës së Kuvendit për periudhën 21 janar – 1 mars 2019 *(neni 26, pikat 5 dhe 6, i Rregullores, votim i hapur me shumicë të thjeshtë)*
5. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar – 8 shkurt 2019 *(neni 27, pikat 3 dhe 4, i Rregullores, votim i hapur me shumicë të thjeshtë)*

6. Paraqitja në Kuvend e kalendarit të raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për veprimtarinë e vitit 2018 *(neni 103, pika 1, i Rregullores)*

7. Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”. *(nenet 20 dhe 21 të Rregullores, votim i hapur me shumicë të thjeshtë)*

8. Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”. *(nenet 20 dhe 21 të Rregullores, votim i hapur me shumicë të thjeshtë)*

9. Dekreti nr. 11.061, datë 18.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Dëtmir Bushati, Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme”. *(neni 98, pika 1, i Kushtetutës, dhe neni 58, pika 2, i Rregullores, votim i hapur me shumicë absolute)*

10. Dekreti nr. 11.062, datë 18.01.2019 “Për emërimin e Kryeministrit, zotit Edi Rama, edhe Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme”. *(neni 98, pika 1, i Kushtetutës, dhe neni 58, pika*

2, i Rregullores, votim i hapur me shumicë absolute)

Gramoz Ruçi – Të futet media!

Seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur!

Në mbështetje të nenit 74, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 42, pika 2, të Rregullores, sot hapim Sesionin IV parlamentar të Legjislaturës IX.

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Me rastin e hapjes së sesionit të ri, uroj një vit të suksesshëm në punën e secilit dhe në punën e përbashkët për të mirën e atdheut tonë të përbashkët!

Përpara se të paraqes disa nga prioritetet e këtij sesioni, më lejoni t'ju bëj një bilanc të shkurtër për sesionin që lamë pas.

Gjatë sesionit të kaluar miratuam 58 ligje, midis tyre 3 të reformës në drejtësi. U konstitua dhe filloi punën Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

U hap kështu rruga për plotësimin e Gjykatës Kushtetuese, zgjedhjen e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, SPAK-ut, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Gjykatës së Posaçme.

Vetingu po vazhdon dhe konfirmimi i 48% të subjekteve provon edhe një herë nevojën substanciale të rindërtimit tërësor të sistemit të drejtësisë.

Në ushtrim të përgjegjësi për procesin e integritetit evropian, Kuvendi ka programuar deri në prill të 2019-s plotësimin e 6 objektivave dhe 46 masave të planit të veprimit.

Manuali për sistemin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së në nivel parlamentar, i miratuar gjatë sesionit të kaluar, ofron udhëzime për deputetët dhe njëherësh për ekspertët.

Në takimin e dytë me përfaqësues të qeverisë dhe të institucioneve të pavarura u tërhoq vëmendja për mosnxjerrjen në kohë ose në formë të plotë të disa akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të miratuara nga Kuvendi.

Në dhjetor miratuam manualin e raportimeve të institucioneve të pavarura në Kuvend.

Sigurisht, sesioni që lamë pas mund të ishte më produktiv nëse për objektivat e tij do të ishte edhe pjesëmarrja aktive e opozitës në Kuvend.

Në veprimtarinë parlamentare duhet të mbajmë parasysh se jo çdo veprim ligjërish të drejtë është edhe moralisht i drejtë.

Fitorja e zgjedhjeve duhet të jetë në shërbim të misionit kombëtar dhe jo e kundërta.

Dëshiroj, sinqerisht, që debati i munguar në sesionin që lamë pas të kompensohet në këtë sesion, pasi legjitimiteti dhe përfshirja, jo komoditeti, përjashtimi apo vetëpërjashtimi, e bëjnë një parlament vërtet funksional.

Prezenca e opozitës sigurisht që e bën sesionin parlamentar më të vështirë, por njëherazi e bën atë shumë produktiv; e bën konfliktual, por edhe më demokratik; e bën më të trazuar, por më të dobishëm.

Të nderuar deputetë,

I kemi të gjitha mundësitë që sesioni parlamentar që po nisim të vulojë në kujtesën e secilit prej nesh dhe në kujtesën kolektive të shqiptarëve si sesioni i çeljes së negociatave me Bashkimin Evropian.

Ne kemi avancuar në realizimin e përgjegjësi të programuara në Planin e Veprimit për Integritetin Evropian, por në republikat parlamentare përgjegjësitë e legjislativit shkojnë përtej tij. Detyrat tona janë të përbashkëta me degët e tjera të qeverisjes.

Shpreh bindjen se opozita, duke respektuar alternativën e saj politike, do të bëhet në këtë sesion një vlerë e shtuar në segmentin e fundit të rrugëtimit drejt çeljes së negociatave, njëherësh

edhe shumica parlamentare duhet të tregojë më shumë durim dhe vullnet për të bashkëpunuar.

Duhet të duam dhe të dimë të shfrytëzojmë shansin që na ka dhënë të gjithëve bashkë Këshilli European. Nuk e kemi më luksin të biem në kurthin e ambicieve partiake dhe të ndriçimit nga drita që vjen nga Europa, sepse mjaft e kemi penguar aspiratën europiane të shqiptarëve me kapriçot tona.

Të nderuar kolegë, reforma zgjedhore vazhdon të qëndrojë në krye të agjendës parlamentare për këtë sesion. Të gjithë e dimë që objektivi për realizimin e saj nuk u bë në sesionin e kaluar. Është përgjegjësia jonë kushtetuese, politike dhe kombëtare që zgjedhjet vendore të 30 qershorit të jenë të lira dhe të ndershme, sipas standardeve të pranuara ndërkombëtarisht. Prandaj të gjithë duhet të mbledhim mendjen dhe të miratojmë sa më shpejt ndryshimet e Kodit Zgjedhor, sipas rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it për tri zgjedhjet e fundit. Zgjedhjet nuk duhet të pengojnë finishin tonë drejt Europës, por duhet të bëhen një oportunitet për të treguar sinqeritetin tonë politik pro europian.

Pra të gjithë, si ligjvënës, si grupe parlamentare dhe si parti politike duhet t'i përgjigjemi aspiratës europiane të shqiptarëve dhe të mos lëmë për nesër asnjë detyrim, që kemi për ta kryer sot. Pra, shumica dhe opozita të bashkojnë vullnetin, ambiciet dhe energjitë e tyre pa kushte.

Gjatë këtij sesiioni do të përfundojë plotësimi dhe ngritja e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, që nga Gjykata Kushtetuese, SPAK-u, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Byroja Kombëtare e Hetimit dhe gjykatat e posaçme.

Në këtë sesion do të përfundojë miratimi i akteve të paketës së reformës, si ligji "Për magistraturën", ligji "Për Policinë Gjyqësore", ligji "Për shërbimin përmbartimor privat", projektvendimi "Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut", ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit e të tjera.

Të nderuar kolegë, nuk kemi zgjidhje tjetër, përveçse t'u dedikohemi detyrimeve për të rindërtuar sistemin dhe për t'u përgjigjur aspiratave të shqiptarëve për drejtësi që bën drejtësi.

Refoma në drejtësi nuk është vetëm vetingu, por të tria proceset paralele, pra vetingu, krijimi i institucioneve të reja dhe dhënia e drejtësisë me profesionalizëm, paanësi dhe integritet. Dy aspektet e para kërkojnë zgjidhje teknike, ndërsa dhënia e drejtësisë nuk mund të realizohet me atë lehtësi që llogaritet pasuria, vlerësohet figura apo krijohen organet e reja të drejtësisë.

Ky është një proces adaptiv dhe kërkon një lidërship adaptiv të reformës dhe të vetë sistemit. Prandaj Kuvendi do të kontribuojë që të përfundojë brenda këtij sesiioni krijimi i institucioneve të reja dhe ajo që është më e rëndësishme të përmirësohet rrënjësisht dhënia e drejtësisë për qytetarët. Reforma dhe vetingu nuk na duhen për statistika, por na duhen për një drejtësi të re sipas Kushtetutës, ligjit, por edhe në shërbim të qytetarëve.

Forcimi i kontrollit parlamentar ndaj qeverisë dhe institucioneve, si një objektivi konstant i parlamentit, do të kontribuojë në realizimin e prioritetëve të mësipërme. Në këtë kuadër Kuvendi do të monitorojë edhe zbatimin e strategjisë kombëtare të miratuar nga qeveria, efektet në ekonomi, sistemin e mirëqenies dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

Dëshiroj t'ju informoj se kemi filluar përgatitjet për 100-vjetorin e ndarjes nga jeta të Ismail Qemalit, si dhe kremtimin në janar të vitit 2020 të 100-vjetorit të parlamentarizmit shqiptar. Këto dy ngjarje dua që të na inspirojnë për të realizuar me më shumë dedikim objektivat e këtij sesiioni që po nisim sot.

Të nderuar kolegë, plotësimi i sfidave të rëndësishme që na presin nuk tolerojnë asnjë vonesë, asnjë shmangie apo mosplotësim të detyrimeve tona kushtetuese, parlamentare dhe kombëtare. Këtyre sfidave t'u paraprijmë me vizion, t'u shërbejmë me ambicie dhe për realizimin e tyre të çlirojmë të gjitha energjitë tona.

Dera e hapur e Europës, zgjedhjet vendore me standarde të larta, një demokraci funksionale dhe një sistem drejtësie profesional, i paanshëm e me integritet do të mjaftonin për të na bërë krenarë në mbyllje të sesiionit që po nisim sot.

Punë të mbarë!

Përpara se të vazhdojmë me rendin e ditës, sipas traditës, ftoj përfaqësuesit e grupeve

parlamentare, nëse dëshirojnë, të marrin fjalën për hapjen e sesionit të ri.

Fjalën e ka zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Të nderuar kolegë deputetë,

Përpara 4 ditësh Kuvendi i Shqipërisë zhvilloi seancën më të turpshme në këtë periudhë të tranzicionit shqiptar, duke treguar që parlamentarizmi nuk ekziston më.

Vetë mazhoranca me sjelljen e saj ka nënshkruar kapitullimin përballë qeverisë. Kushtetuta nuk ka më vlerë dhe, për fatin më të keq, mazhoranca duartroket këtë rrënim parlamentar.

Kryeministri ju ka lënë vetëm një detyrë, që të ulni dhe të ngrini dorën me urdhrin e tij, ndërsa interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve nuk ekzistojnë më për këtë mazhorancë, e cila në mënyrë të vazhdueshme kontrollohet dhe është kthyer në zëdhënese të qeverisë.

Kryeministri për ju është gjithçka, është qeveria, mandati i deputetit, është parlamenti, gjyqtari, prokurori, biznesi, ekonomia, krimi dhe garancia.

Sot është Kryeministër dhe ministër i Jashtëm njëkohësisht, as më shumë dhe as më pak, njësoj si Enver Hoxha në kohën e tij.

Po perfrazoj një thënie të zonjës Art Dade, një nga figurat kryesore politike të Partisë Socialiste, ish-ministre e Jashtme, deputete për shumë vjet dhe anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste, e cila thotë: “Edi Rama dhunoi PS-në, themeluesi i rilindjes që ka pushtuar socialistët duke shkatërruar lirinë dhe debatin në Partinë Socialiste”. Ajo shton se asnjë nuk hyn dot në selinë rozë, sepse duke parë se në çfarë niveli është demokracia në Partinë Socialiste, aq më keq funksionon qeveria dhe qeverisja nën Edi Ramën.

Këto që thotë zonja Dade, ka edhe shumë nga ju, të nderuar kolegë deputetë të mazhorancës, që i thonë nën zë, pra për këtë zhvlerësim dhe depersonalizim që po i bën Kryeministri jo thjesht parlamentit, por gjithsecilit nga ju. Frika e mandatit ju bën që të ulni kokën dhe të votoni jo vetëm thjesht kundër vetes suaj, por, për fat të keq, kundër interesave të vendit. Kjo mazhorancë me këtë që po bën po shkruan historinë më të keqe të politikës shqiptare, veçanërisht të këtij parlamenti.

Ju po i thoni Kryeministrit: “Bëj si të duash, si të të dojë qejfi! Merr çfarë të duash, sepse për ne e rëndësishme është të jemi në këtë sallë dhe interesat e këtij vendi janë më të vogla sesa qeverisja dhe interesi personal”.

Qeverisja është shndërruar në një kopje të shëmtuar të sistemit putinian apo regjimeve autoritare orientale. Vendi po shkon drejt qorrollisjes pa fund dhe kombi drejt problemeve të mëdha për shkak të aventurës dhe të vendosjes së pushtetit mbi shtetin. Nga ky pushtet ka dhe do të ketë vetëm probleme, do të ketë më shumë korrupsion dhe varfëri, më shumë krim dhe pasiguri, më pak shpresë, më pak shqiptarë në Shqipëri, më shumë moskuptim dhe konflikt mes shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Shqipëri, më shumë klane dhe dhunim të drejtave, më pak liri, më pak ekonomi, më pak biznese, më pak marrëveshje në interesa të Shqipërisë dhe më shumë marrëveshje në interes të pushtetit me korrupsionin dhe me krimin.

Çfarë shteti po ndërtojmë?! Le t'i bëjë gjithsecili nga ne pyetjen vetes: a kontrollojnë sot qeveria gjithçka: lirinë, punën, biznesin, pronën, jetën? Duke i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, arrijmë të kuptojmë se jetojmë në situatat më të vështira të një regjimi autokratik oligarkik, dhunues dhe, sipas Kryeministrit: “Shqiptarët nuk kanë parë gjë ende”. Po jetojmë periudhën më të errët ku qytetarët nuk mund të votojnë të lirë. Zgjedhjet i përcakton krimi dhe paraja e krimit. Biznesi varet tërësisht nga qeveria dhe nga marrëveshjet me të. Punësimi në shtet dhe në privat varet nga qeveria. Liria është kthyer në një koncept abstrakt dhe të pavlerë. Arroganca, fyerja, tallja, banaliteti janë ulur këmbëkryq në çdo hallkë të qeverisë dhe në këtë Kuvend. Kjo qeveri i ka vendosur shqiptarët përballë dy alternativave: të pranojnë fatin e tyre të varfërisë dhe të përbuzjes ose të largohen nga ky vend drejt rrugëve të botës për një jetë më të mirë.

Në komunizëm, nëse ishte kundër qeverisë të arrestonin, të internonin, të çonin në kampe përqendrimi, ndërsa sot të lënë pa punë, të diskriminojnë, të lënë pa ekonomi dhe të detyrojnë që të largohesh nga familja jote, nga vendi yt si i pashpresë. Kryeministri është i lumtur që të largohen sa më shumë shqiptarë, të largohen mjekë, profesorë, inxhinierë, infermierë, të rinj dhe të reja, njerëz aktivë me

mendim dhe me gjykim që nuk e pranojnë të keqen. Le të largohet kushdo që është ndryshe dhe nuk e pranon këtë realitet, sepse kështu ai e ka më të lehtë që të manipulojë, të blejë dhe të përjetësojë pushtetin.

Filozofia politike marksiste-komuniste për eliminimin e kundërshtarëve politikë dhe eliminimet e borgjezisë janë zëvendësuar me politikën e rrënimit ekonomik dhe largimin nga vendi të pjesës më aktive dhe produktive të shoqërisë shqiptare. Qeveria nuk është as më shumë dhe as më pak, por një fasadë e lyer që kërkon të fshehtë rrënimin dhe kalbëzimin e qeverisjes, e cila po gangrenizon shtetin dhe po sëmur të gjithë shoqërinë shqiptare.

Interesat tona kombëtare kanë qenë pjesë e angazhimit të përbashkët politik dhe kanë sjellë zhvillime të jashtëzakonshme për shqiptarët, si: pavarësinë e Kosovës, marrëveshjen e Ohrit, anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, liberalizimin e vizave, por sot janë vënë në pikëpyetje nga interesat mesquine dhe nga pushtete individësh që sillen me kombin dhe sakrificat qindravjeçare si tregtarë, pazarxhinj, pronarë të kombit dhe të interesave kombëtare. Kur Europa flet për krimin, korrupsionin, ai kërcënon me aleanca fetare orientale. Marrëdhëniet me institucionet dhe miqësia me Shtetet e Bashkuara po zëvendësohen me qëndrime absurde dhe me interesa lobiste personale.

Të nderuar deputetë,

Aventura në politikën e jashtme apo përdorimi për interesa personale është me pasoja dhe shumë i rrezikshëm për vendin dhe kombin. E kam thënë edhe herë të tjera, që në fillim të mandatit të kësaj qeverie në këtë parlament, se sfidat tona si komb janë më të mëdha sot, duke parë edhe koniunkturën e reja në politikën globale dhe influencat e reja në Ballkan, sidomos sjelljen paternaliste të Tiranës ndaj Kosovës dhe Maqedonisë. Nuk është e nevojshme të inventosh apo të supozosh, por mjafton të kesh durimin të analizosh materiale pa fund shqetësuese të strukturave të sigurisë europiane, të SHBA-ve apo të NATO-s për të kuptuar se nuk jemi në vitet 2007, 2009, as kur u bë Kosova e pavarur dhe as kur u bë Shqipëria vend anëtar i NATO-s. Kosova e pavarur filloi këtu, me vizitën dhe me deklarinimin e Presidentit Bush, në Tiranë në konferencën e shtypit me

Kryeministrin Berisha dhe vazhdoi me mbështetjen e plotë të të gjitha vendeve të BE-së, por edhe me kundërshtimin e hapur të mikut të Serbisë, Putinit. Shumë zhvillime ka pasur nga ajo kohë. Pas vitit 2013 Serbia ka filluar të rikuperojë dukshëm diplomacinë ndërkombëtare, veçanërisht në Europë. Vuçiçi falë edhe marrëdhënieve të shkëlqyera me Tiranën, fitoi autoritetin e liderit modern, i aftë për të ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera miqësore me Kryeministrin dhe me Shqipërinë dhe qëllimisht, sipas interesit të tij, filloi ta shohë marrëdhënien me Kosovën dhe dialogun nëpërmjet Shqipërisë, dëshirë e hershme kjo e Serbisë, jo nëpërmjet ndërmjetësimit dhe forcës në bashkëpunim me SHBA-të.

Në një diskutim rajonal me Shqipërinë, e cila nuk e ka peshën ekonomike, ushtarake apo gjeopolitike të nevojshme për t'u bërë ndërmjetëse, nëse Serbia forcoi më shumë marrëdhëniet me Rusinë, për fatin e keq, partneriteti ynë dhe marrëdhëniet strategjike me SHBA-të dhe me BE-në u zëvendësuan me interesa personale, madje ndonjëherë në të kundërt. Nëse Serbia dje ishte problemi i Ballkanit për BE-në dhe SHBA-të, sot është vend kandidat i BE-së përpara Shqipërisë dhe ka arritur të ndërtojë marrëdhënie solide edhe në Washington. Siç thashë më sipër, Serbia nuk hoqi dorë asnjëherë nga aleati i saj historik dhe strategjik, Rusia, e cila, pas disfatës së viteve '90 dhe shpërfilljes deri në vitin 2007, është sot prezent në Ballkan ushtarakisht me shërbimet inteligjente, ekonomikisht dhe mediatikisht, duke krijuar lidhje të hapura, të fshehta me qeveritë e Ballkanit.

Që në vitin 2007 në Konferencën e Sigurisë në Mynih Presidenti rus Putin ka theksuar se: "Ballkani është *backyard*-i i Rusisë". Pa dyshim që rojtari ka vendosur të ketë Serbinë. Asnjëherë nuk e ka ndalur luftën kundër anëtarësimit të vendeve të Ballkanit në NATO dhe në BE me ndërhyrje të drejtpërdrejta. Po mbështet ushtarakisht fuqishëm Serbinë. Po ashtu dua të kujtoj se ministri i Jashtëm Lavrov ka deklaruar hapur se: "Nuk ka kufij të përhershëm në Ballkan". Serbia krahas luftës për të penguar Kosovën në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare dhe heqjes së njohjes së pavarësisë nga shtetet që e kanë njohur tashmë, ka kërkuar dhe kërkon që pjesë e

dialogut Serbi- Kosovë të jetë domosdoshmërisht Rusia.

Putini deklaroi në Serbi mbështetjen pa kushte për Serbinë dhe përcaktoi SHBA-në, BE-në dhe Kosovën faktorë destabiliteti në rajon.

Më qartë se kaq nuk e di se ç' duhet të thotë, që të kuptojmë se po i kërkohet Ballkanit të futet në një spirale tjetër dhe, pa dyshim, shqiptarët nuk mund të jenë të fituar.

Të gjithë analistët shqetësohen për një vakum të krijuar në rajonin e Ballkanit. Mjafton të kujtoj fjalët e presidentit Makron në Parlamentin Europian se Ballkani po rrëshqet drejt kontrollit nga influenca ruse dhe turke.

Çka përmenda më sipër tregon qartë se shumë zhvillime nuk kanë qenë dhe nuk janë në favorin e shqiptarëve, përkundrazi.

Hapja e debatit për ndryshimin e kufijve dhe mbështetjen nga Tirana, duke vendosur në pikëpyetje atë që është realizuar me mbështetjen e BE-së dhe SHBA-së, përbën një rrezik të madh, në gjykimin tim.

Të më ndjeni për naivitetin, por në idenë e ndryshimit të kufijve apo të shkëmbimit të territoreve, të paktën deri tani, nuk shoh as qëllime të realizuara, as garantues të integritetit të Kosovës e për më tepër të asaj që themi të gjithë së bashku interesave të shqiptarëve të bashkuar në BE. Përkundrazi, shoh mundësinë e rifillimit të riciklmit të konflikteve.

Ne çdo gjë e kemi arritur falë mbështetjes së SHBA-së, NATO-s dhe BE-së. Atëherë, çfarë po ndodh që nuk ka një unitet në këto vende? Çfarë po ndodh që Gjermania është kundër ndryshimit të territoreve?

Serbia nuk do marrëveshje me Kosovën. Ajo do vetëm Kosovën. Ajo nuk është ndalur në asnjë moment për të bllokuar Kosovën. Përballë kësaj situatë Shqipëria duhet të ketë një qëllim të qartë, jo individual, jo të një qeverie apo të një kryeministri, por një qëndrim kombëtar, nga Presidenti deri te secili deputet i këtij Kuvendi.

Do t'i kthehem situatës në vend, të nderuar kolegë deputetë.

Krimi dhe korrupsioni e dominojnë sot vendin. Lord Desbraun në Dhomën e Lordëve një javë më parë theksonte: "Nga njohuria ime, një Ballkan Perëndimor i destabilizuar nga armët, droga, trafikimi i njerëzve dhe pastrimi i parave, do të ketë pasoja jo vetëm në Ballkan, por edhe në vendin tonë, këtu në Londër, në

bizneset tona. Ajo minon mënyrën tonë të jetesës dhe vetëm për këtë arsye, qoftë edhe egoiste dhe jo për tjetër gjë, ne kemi detyrën kolektive për t'u angazhuar dhe për të siguruar një Ballkan Perëndimor të liruar nga kjo tirani kurdo që të vijë".

Po ashtu kemi sfida të mëdha përpara. Varfërisë ekonomike dhe politike të kësaj qeverie ne nuk duhet t'i shtojmë qëndrimin tonë të papërgjegjshëm në këtë parlament.

Është e domosdoshme të kemi një qëndrim për të forcuar rolin e këtij parlamenti, për të garantuar zgjedhje të lira dhe të barabarta si detyrim i çdo deputeti, detyrim i çdo institucioni, detyrim përballë të gjithë shqiptarëve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mund të merresh gjatë dhe të flasësh për problemet e qeverisjes së kaluar apo të sotme, por asgjë nuk do të ndryshojë, është i njëjti përgjegjës, e njëjta qeveri, një qeveri politike, e cila ka vetëm një qëllim, bashkëpunimin për interesa korruptive.

Protesta e studentëve jo vetëm tregoi kalbëzimin e kësaj qeverie, por krijoi edhe shpresën se shoqëria shqiptare nuk mund të ulë kokën dhe të përulet përballë së keqes, siç ndodh këtu në parlament. Studentët janë më shumë se politikë, janë e djeshmja demokratike, frymëzimi i së sotmes dhe fytyra e së ardhmes.

Faktikisht, ne as kemi pasur, as nuk kemi qeveri të Rilindjes dhe as nuk do ta kemi.

Kjo maxhorancë, të cilës ju i hapët rrugë me ndryshimet, do të shkatërrojë akoma më tej parlamentin, Kushtetutën, të gjitha institucionet dhe pushtetet vetëm për interesa personale dhe korruptive.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Mediu!

Urdhëroni, zonja Kryemadhi, në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së!

Monika Kryemadhi – Problemi më i madh nuk qëndron te ne që jemi këtu, por te njerëzit që janë jashtë. Sot ne hapim në mënyrë zyrtare parlamentin, por në fakt në memorien e shqiptarëve dhe të ndërkombëtarëve ka mbetur seanca e kaluar, ku opozitës iu hoq e drejta për të folur, sepse kanë frikë të dëgjojnë atë që mendon opozita. Edhe po të jetë e gabuar, nuk ka asgjë të keqe të dëgjosh opozitën, përkundrazi, të krijon mundësinë që të përmirësohesh.

Sot do të kisha shumë dëshirë të flisja për axhendën e parlamentit, të cilën pjesa më e madhe e grupit të maxhorancës (më vjen keq dhe për ata deputetë të vjetër që vijnë nga Partia Socialiste), nuk e kupton. Hapja e negociatave për Shqipërinë është një gjë shumë e rëndësishme, e cila kërkon një axhendë të qartë, që e dëgjua të na e thotë edhe Kryetari i Parlamentit, por jam e bindur që nuk e kupton se ç'do të thotë axhendë.

Që të hapen negociatat, zoti Kryetar i parlamentit, në radhë të parë duhet dialogu politik dhe nuk ka sesi të ketë dialog politik, kur ju nuk i jepni të drejtën opozitës për të folur. Që të hapen negociatat, duhet të zgjidhet një prokuror e Përgjithshme apo Prokuror i Përgjithshëm me 84 vota dhe nuk ka se si të zgjidhet, kur ju nuk keni një dialog politik. Duhet miratuar reforma zgjedhore, e cila mban peng zgjedhjet e lira e të ndershme për shqiptarët, por nuk ka se si të zgjidhet kur mbahet peng kjo reformë zgjedhore, sepse është e vetmja mënyrë për të vjedhur dhe për të blerë votat e shqiptarëve.

Mbahen peng negociatat, sepse nuk do Kryeministri i Rilindjes. Ai mban peng një shtet dhe një popull të tërë, sepse ashtu i leverdis. Por, në fakt, të gjitha këto që ne themi këtu kanë të bëjnë me axhendën e Integritetit Europian të Shqipërisë dhe të klasës sonë politike. Shqiptarët presin 300 mijë vendet e punës, të cilat u janë premtuar dhe sot s'kanë asgjë.

Shqiptarët presin uljen e çmimit të energjisë elektrike që iu premtua, por, përkundrazi, u është rritur. Shqiptarët presin një pagë më të mirë, por, përkundrazi, u shtohen taksat. Shqiptarët presin legalizimin e shtëpive të tyre, por, përkundrazi, dërgohen ruspat e oligarkëve për t'u shembur shtëpitë. Shqiptarët presin që fëmijët e tyre të shkollohen, por, përkundrazi, u mbyllen dyert e fakulteteve dhe të universiteteve me çmimet e taksat e larta.

Çfarë shikojmë tjetër?! Shikojmë që kemi një qeveri totalisht inekzistente, e cila nuk përfaqëson asgjë. Më vjen keq për socialistët, ish-kolegët e mi, të cilët jo vetëm nuk e gjejnë veten aty, por përkundrazi, ndihen të shfrytëzuar dhe të frustruar.

Nga kjo foltore dua të falënderoj ata studentë dhe pedagogë, të cilët i dhanë zemër dhe thyen frikën e protestës, pra që të protestosh

kundër këtij njeriu, nuk ka asgjë, përkundrazi, e detyron të tërhiqet; të protestosh kundër këtij njeriu nuk është asgjë, përkundrazi, shqiptarët e shokët e tij do ta kuptojnë shumë mirë se ai i shet ata, edhe pasi kanë firmosur për të vjedhur, për koncesione apo për skema të tjera mashtrimi për rrëmbimin e parave të shqiptarëve.

Protesta e studentëve na dha një mësim shumë të mirë. Më i shëmtuar është fakti që shikon pedagogë, të cilët shpërblehen me vendin e tyre si anëtarë të Bordit të Bankës së Shqipërisë, por edhe këtë duhet ta rishikojmë, sepse keni firmosur për tre anëtarë të Bordit të Bankës, ku për secilin ka nga 28 firma, që i bie të jenë 84 firma, por ju nuk keni më shumë se 78 mandate, kështu që i keni të pavlefshme. Jam e bindur që Ulsi thotë se nuk është e vërtetë, por kjo është e vërtetë. Të paktën i thoni atij dekanit të Juridikut të mos i kërcënojë studentët, se bolla ka shërbyer; thojnë dhe Eda Luçit, bashkëshortes së Sokol Krajës, ish-drejtorit të Doganave të Partisë Socialiste, të mos i kërcënojë studentët tek Ekonomiku, por edhe shumë të tjerëve që marrin përsipër t'i dalin për Zot dhunimit të studentëve. Pas studentëve nuk janë partitë politike, mos keni frikë se do t'i shikoni edhe partitë politike, por plotësoni 8 kërkesat e studentëve, sepse janë shumë të thjeshta.

Kam një sugjerim për miket time Belinda: mos dëgjo se çfarë thotë ky, se do të të marrë në qafë siç mori në qafë Arben Ahmetajn dhe Damian Gjicknurin, të cilët shumë shpejt do të dalin përpara drejtësisë! Ashtu e mori në qafë edhe Arta Markun.

Mos qesh, Beni, se të kam mik dhe koleg, por do të mbash përgjegjësi për lavatriçen e parave, në të cilën është kthyer Shqipëria sot, ashtu siç do të mbajë përgjegjësi Damian Gjicknuri për firmën indiane, se cilës i dha panele diellore. Do të zbulohet shumë shpejt se kush fshihet pas asaj firme, e cila vjen në emër të një kompanie indiane. Do të zbulohen, ashtu siç u zbuluan ofertat e Unazës së Re, se si u vodhën 18 milionë euro vetëm me një *offshore* dhe shumë të tjera.

Prandaj, Belinda, mos e dëgjo këtë Kryeministër, që kujton se me lakuriqësinë e tij do t'i habisë shqiptarët si në vitin 2000, përkundrazi, shqiptarët janë mërzitur, sepse ai nuk ka më ndonjë risi në jetën artistike, kulturore, qoftë edhe seksuale. Mos dil të

gënjeshe e të thuash se PPP-ja e famshme Kashar-Thumanë do t'u kalojë studentëve. Nuk është e vërtetë dhe mos gënjeni, sepse ajo është planifikuar në zero. Hiqini koncesionet e Vilma Nushit, hiqini edhe koncesionet e tjera, me të cilat grabisni paratë e shqiptarëve dhe i çoni në xhepat e oligarkëve; merrini 118 miliardë lekët e skemës së mashtimit të TVSH-së, dhe Arben Ahmetaj e di shumë mirë, sepse me pronarët e atyre firmave të mëdha dhe me firmat e tjera fantazmë kanë mashtruar dhe u kanë vjedhur shqiptarëve mbi 100 milionë euro, dhe jepjani biznesit të ndershëm shqiptar 100 milionët euro, të cilat nuk ia kthen me rimbursimin e TVSH-së.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Prandaj, Beni, të dua shumë, por do të të marrë në qafë, siç të mori, sepse të mori firmën dhe të shiti, siç shkarkoi ministrin e Brendshëm brenda natës pse i arrestoi Vangjush Dakon të lidhur me grupin e "Abdylajve", dhe u kërcënuar: "Nëse ti nuk më nxjerr nga rajoni i policisë, unë do të hap librin dhe defterin e dhënave dhe të përgjimeve të telefonatave të Edi Ramës në Shijak". Kështu që ky njeri do t'ju mbajë peng ju të parët, jo ne, se ne na keni në rrugë dhe këtu, duke u përplasur dhe duke u ballafaquar me ju me fjalë apo me vepra. Por po ju them vetëm një gjë: historia do t'ju rëndojë aq shumë mbi shpatullat tuaja, sa që nuk do të ngrini dot kokë deri në 7 breza. Mos e bëni këtë mëkat për veten tuaj, për fëmijët tuaj dhe për fëmijët e shqiptarëve.

Sinqerisht, më vjen keq, e kam thënë dhe e them, që vitet më të bukura të jetës sime i kam kaluar duke protestuar me Partinë Socialiste dhe duke punuar për të, por sot jam e bindur që fytyra e asaj partie nuk jeni ju, fytyra e asaj partie janë me qindra e mijëra socialistë jashtë kësaj sale, të cilët janë të zemëruar dhe ju e njihni më mirë se kushdo tjetër urretjen që kanë socialistët. Ndoshta opozita nuk ka forcë për t'i marrë 74 mandatet tuaja sot në këtë sallë, por do t'ju them vetëm një fjalë: urretja e socialistëve do t'ju tërheqë zvarrë ju dhe këdo tjetër që ka grabitur vlerat më të mira që ka ajo parti.

Ju bëj thirrje për herë të fundit: zbatoni Rregulloren e Kuvendit dhe na e jepni fjalën kur është për të folur, sepse, pa një opozitë në parlament, edhe ju do të jeni viktimat e radhës së këtij njeriu. Këtij njeriu nuk i vjen keq për veten e tij, mos mendoni se ka për t'i ardhur keq për ju.

Bëjeni listën, sa jeni këtu, në grup. Të gjithë jeni viktimat e tij, në mos sot, do të jeni nesër.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Kryemadhi!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka zoti Basha.

Lulzim Basha – Të dashur bashkëqytetarë,

Nga kjo sallë kam paralajmëruar në mënyrë të përsëritur gjatë një viti e gjysmë se projekti i vetëm i Edi Ramës është asgjësimi i çdo procesi dhe i çdo institucioni politik për ta qeverisur dhe për ta sunduar Shqipërinë vetëm me një grusht oligarkësh e kriminelësh. Hap pas hapi keni parë se si u vu në jetë ky projekt.

U asgjësuan zgjedhjet; u asgjësua e drejta e votës, e drejta elementare e qytetarëve në demokraci për t'i përzgjedhur me votë ata që do t'i përfaqësojnë në këtë sallë, ata që do të mund t'i mbrojnë interesat e tyre në këtë sallë, ata që do të mundën nga kjo sallë të kalojnë ligje e të miratojnë vendime, që t'ua bëjnë jetën pak më të lehtë e jo më të vështirë.

U asgjësua Kuvendi. Sot kjo sallë nuk përfaqëson interesin publik, sepse ata, që kanë sot forcën e kartonëve, e morën atë nëpërmjet forcës së krimit dhe sot e gjithë ditën mbrojnë vetëm krimin e favoret e tij. Ky Kuvend sot përfaqëson vesin më të shëmtuar në 28 vjet pluralizëm, antivlerën e ngritur në pedestal, hajdutërinë e përzier me arrogancë dhe nënçmimin e të pamundurave. U asgjësua Gjykata Kushtetuese, mbrojtësja e vetme e garancive kushtetuese, e qytetarëve shqiptarë dhe e proceseve politike.

U asgjësua këtu, nga kjo sallë, prokuroria. Tani i erdhi radha edhe asgjësimit të Partisë Socialiste. Sot në pushtet ka vetëm një njeri, i cili qeveris me një grusht oligarkësh dhe kriminelësh, të cilët kontrollojnë të gjitha pushtetet në vend, jashtë çdo kontrolli dhe procesi politik. Sot ministrat në pushtet nuk janë më as përfaqësues të popullit, as përfaqësues të Partisë Socialiste, kundërshtares sonë historike. Sot në Shqipëri ka vetëm një pushtet, pushteti personal i Edi Ramës. Shikojini pak këta njerëz, më thoni, a i dini emrat e disave prej tyre?!

A e dini emrin e kësaj zonjës, e njihni kush është? A e njihni, o socialistë, kush është kjo zonjë? Kush është kjo tjetra? Po kjo tjetra kush është? I njihni, apo jo? A i njihni cilat janë? Bashkëqytetarë socialistë, anëtarë të Partisë

Socialiste, a i njihni cilat janë këto? Çfarë janë? Janë kukullat e këtij. Më thoni ju a i mbani mend emrat e këtyre zonjave? Kaq po ju pyes. Nuk po u vë as nofka e as mbiemra. A i njihni cilat janë? Kush është kjo zonja? E njihni kush është dhe çfarë është? Ministre e kujt është? Çfarë është? Çfarë ka bërë për këtë vend? Nga vjen?

(Reagim pa mikrofon.)

Mos pëllit, sepse, në qoftë se tani ka filluar të të dhembë, shumë shpejt do të të dhembë shumë më shumë. Mos pëllit! Cilët janë këta? Nga i mori? Nga i nxori? Për çfarë i nxori?

(Reagim pa mikrofon)

Mos pëllit! Është vetëm fillimi, do të të dhembë edhe ty më shumë... Mos ki merak! Duro!

(Reagim pa mikrofon)

Këtu do t'i sqarojmë të gjitha. Mos ki merak! Cilët janë?

Gramoz Ruçi – Ju lutem, zoti Kryeministër!

Zoti Basha, vazhdoni diskutimin! Nuk keni punë me emrat.

Lulzim Basha – Zonja anëtare të Partisë Socialiste, a i njihni cilët janë këta njerëz? A ju përfaqësojnë ju, apo përfaqësojnë vetëm xhepat, kontot bankare dhe paktet e zeza të Edi Ramës me një grusht oligarkësh? Ata i kanë miratuar; ata ia kanë sjellë.

Pazaret e milionave, 20 milionë euro kilometri tek Unaza, këta jua kanë sjellë, që ky të vazhdojë të firmosë për çdo gjë, pa e penguar njeri. Në fakt, atë bënte edhe më parë, por këta kishin njëfarë profili politik, kanë bërë beteja politike, kanë ndjekësit e tyre. Pa dyshim treçereku i tyre duhet të shkojë për ndjekje penale, s'ka diskutim. Nëse do të shkojnë për ndjekje penale në një drejtësi të pakapur, e dinë mirë se çfarë i pret, por kjo është një çështje tjetër, të mos i konfundojmë të gjitha bashkë.

Janë njerëz që vijnë nga një profil politik, por përsëri ky i merr vendimet. E hoqën edhe fasadën, nuk kanë më nevojë për fasadë! E kuptoni ku ka shkuar arroganca e një të çmenduri, i cili e pikturon veten lakuriq në *Instagram*? E kuptoni?! Vendi është në duart e një të marri, i verbuar nga urrejtja për popullin; i krimbur nga paraja që u ka marrë njerëzve, i çmendur nga arroganca e pafre; i dalë binarësh, pasi ka shkelur themelin e demokracisë europiane: ndarjen dhe kontrollin e pushteteve!

Ja, ky është fundi i rrugës i të gjithë autokratëve të zhytur në krim dhe korrupsion: humbasin çdo sens mase.

Shikojini edhe një herë, zonja të nderuara: a i njihni? Cilët janë emrat e tyre? Zero! Zero!

Bëri sikur imitoi Ismail Qemalin dhe Hasan Prishtinën, por i ra fasada dhe doli si Enver Hoxha, edhe Kryeministër edhe ministër i Jashtëm.

Nivelin e kabinetit të Surrelit e ka të nivelit të Enver Hoxhës, të Lenka Çukos dhe të Pali Miskës, apo jo?! Kështu e ka.

Natyrisht, asgjë e mirë nuk mund të vijë nga kjo. Faturën për këtë vazhdon e paguan populli. E paguajnë studentët, e paguajnë pensionistët, sipërmarrja e vogël, të papunët, shtresa e mesme, pronarët, ish-të përndjekurit. Vendi sot është në emergjencë kombëtare!

Faturën për këtë të marrë, i cili, pasi ka vjedhur e zhvatur çdo gjë, do të poshtërojë shqiptarët dhe Shqipërinë deri në pikën e fundit, e paguajnë studentët. Nuk ka lekë për të ulur tarifat dhe del një nga figurinat e thotë: do t'ia marrim koncesionit Kashar-Thumanë. Pse? Ai, në fakt, duhet anuluar dhe duhen çuar para ndjekjes penale ata që e bënë, që ta dish mirë ti, edhe ata të bandës së Lushnjës.

(Reagim pa mikrofon)

Po, po.

Por shqiptarët sot duhet ta dinë se në buxhetin e vitit 2019 ky mashtrues, ky hajdut psikik, ka rezervuar zero lek për rrugën Thumanë-Rrogozhinë. Ka ku të marrë lekë! 33 milionë i ka Vilma Nushi, i ka Jani Karadako-Paradako, si e ka ai tjetri. Tri koncensionet e shëndetësisë kapin vlerën 33 milionë euro! 21 milionë i ka Klodi i Benit (*I drejtohet zotit Arben Ahmetaj*) për tre inceneratorë! Ato nuk i prek, se pastaj fillon tangon me Benin dhe bien të dy! Nuk i prek ato!

Do të bini, por do të binit më shpejt po t'i prekte ato që ka regjistruar në Holandë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, u morën vesh. Kishim takim me delegacionin zyrtar dhe na treguan. Aty e kishe kompaninë, të regjistruar në parajsë fiskale!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hap pas hapi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tjetër gjë është t'i deklarosh dhe tjetër gjë të të inspektohen ligjërisht, por kemi kohë, mos

ki merak, do të kemi kohë! Tani do të merrem me anonimen që të ka zëvendësuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zoti Ahmetaj, ju lutem, mos ndërhyjni!

Lulzim Basha – Pra, faturën e paguajnë pensionistët, të cilët vuajnë për bukën e gojës. Pra, me pensione që kanë, pasi paguajnë dritat, ujin, qiranë, nuk u ngelen para për bukën e gojës! Janë dhjetëra, mijëra qytetarët, që vidhen përditë me çmimin më të lartë të naftës në Europë, me çmimin më të lartë të energjisë në rajon!

E paguajnë të sëmurët, që shkojnë në spitale, por nuk gjejnë ilaçe, përveçse kur shkon ky (Rama) për të bërë fotografi dhe sapo zhduket, zhduken dhe ilaçet!

Me varëse bosh, ku nuk ka as serume!

E paguajnë qytetarët e varfër, që nuk blejnë dot as gjysmë kile perime, megjithëse çmimet e perimeve po bien përtokë dhe fermerët po i hedhin ato në kanal!

(Ilartitet në sallë)

Ja, qeshin!

E paguajnë dhjetëra, qindra e mijëra fëmijë, të cilëve u janë mbyllur shkollat me vendim të kësaj qeverie, të cilët ecin me orë të tëra për të shkuar në shkollë, ku nuk gjen jo ngrohje, por as banka!

E paguajnë prindërit, që, vit për vit, futen në sagën e mosgjetjes së kopshteve, çerdheve për të sapolindurit e tyre, për të vegjlit e tyre!

E paguajnë policët kokëposhtë, të përdhosur, sepse u duhet të trajtojnë kriminelët VIP-a, miqtë e këtij dhe të tjerëve si ky, si të ishin stjuardesa dhe jo policë, ndërkohë që dhunojnë qytetarët e pafajshëm që dalin për të drejtat e tyre dhe të fëmijëve të tyre!

E paguajnë punonjësit që e kanë rogen minimale 18 mijë lekë të rinj në muaj! Nuk kanë asnjë shpresë për rritje rroge, sepse ekonomia është në kolaps total, me 50 biznese që mbyllen çdo ditë. Rritet ushtria e të papunëve.

E paguajnë të papunët; e paguajnë të shkolluarit, që nuk gjejnë punë; e paguan biznesi i mesëm; e paguajnë familjarë dhe fëmijë ende të parritur, të cilët po i përzë ky, po i çon në emigracion, në eksodin e dytë më të madh të këtij vendi!

E paguajnë mjekët dhe infermierët e frikësuar se mos i heq ky nga puna po nuk

mbushën kuotën e *check up-it* për PPP-në e Vilma Nushit!

E paguajnë pronarët, të cilëve u vidhet prona, madje tani do t'ua vjedhë me ligj, që të ndërtojë ai dhe klika e tij e korruptuar, në bashkëpunim me një grusht oligarkësh, që janë ata që kanë emëruar këta ministra!

Zonja dhe zotërinj socialistë, a e kuptoni pse nuk i njihni? Sepse i kanë emëruar ata, ndërsa ky vetëm i ka firmosur për kaparin që ka marrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...Për rininë e nëpërkëmbur, me shpresë të humbur, që nuk do të ikë, por kërkon të jetojë këtu; për konkursat false që, pasi ia nxjerr në pah Zëri i Amerikës, çohet mulla Rama dhe e sulmon, duke vendosur një rekord të padëgjuar që në kohën e mulla Hoxhës.

Këto janë probleme ekzistenciale për vendin. Nuk ka Kod Zgjedhor dhe reformë zgjedhore që t'i zgjidhë këto probleme! Nuk ka qeveri apo gjysmëqeveri të lidhur me krimin e korrupsionin, si kjo sot, një rekord i zi në 29 vjet, që t'i zgjidhë këto probleme!

Që të kemi zgjedhje të lira dhe të ndershme, në radhë të parë, duhet të arrestohet Vangjush Dako, pastaj duhet të nisë urgjentisht procedimi penal për Damian Gjikhurin, Taulant Ballën, Saimir Tahirin dhe për dhjetëra funksionarë të tjerë të lartë socialistë, përgjimet e të cilëve janë në prokurori, ku dëgjohen pazare me krimin për votat!

Dekriminalizimi i zgjedhjeve është kusht i panegociueshëm, siç është edhe vetingu i politikanëve, siç është kalimi i një ligji antimafia për të konfiskuar pasurinë e çdokujt, oligark apo qeveritar, që është përfshirë në PPP-të, koncesionet dhe tenderët korruptivë, për shkak të të cilëve nuk ka para për të financuar auditorët dhe laboratorët; nuk ka para për të ulur tarifat; nuk ka para për të ndryshuar gjendjen afrikane të konvikteve të studentëve!

Partia Demokratike është e vendosur të bëjë gjithçka që Shqipëria të mos e humbasë shansin dhe rrugën e saj europiane.

Që kjo të ndodhë duhet domosdoshmërisht të nisë procesi i vetingut të politikanëve dhe të largohen njëherë e mirë nga institucionet, duke nisur nga ky parlament dhe nga këto banka, politikanët e lidhur me krimin; duhet të nisë menjëherë dekriminalizimi i zgjedhjeve dhe jo

proceset false të kodeve zgjedhore që përmirësohen, ndërkohë që zgjedhjet përqeshohen; duhet të nisë menjëherë procesi i marrjes së Shqipërisë nga kthetrat e oligarkëve dhe koteleve të tyre në këtë qeveri, atyre që nuk njohin as socialistët, dhe rikthimit të Shqipërisë në duart e qytetarëve shqiptarë!

Unë shpresoj dhe lutem që Partia Socialiste ta gjejë forcën të çlirohet nga kjo bandë kriminelësh dhe nga kryekrimineli, që e ka zaptuar për interesat dhe pushtetin e tij privat dhe personal!

Unë shpresoj dhe lutem që kjo rrugë të mos kalojë nëpërmjet dhimbjeve të papërshkrueshme me kosto të madhe dhe faturë të jashtëzakonshme për vendin. Por faturë më të madhe se rënia e demokracisë, se shkatërrimi i institucioneve të pavarura, se kapja e drejtësisë, se shkatërrimi i zgjedhjeve, se fundi i garës në ekonomi dhe i konkurrencës së ndershme të ekonomisë së tregut dhe e 1,7 milionë shqiptarëve që duan të largohen nuk ka dhe nuk mund të ketë.

Sot, në hapjen e këtij sesioni, dua t'i kthehem edhe një herë paralajmërimit që bëra në nisje të sesionit të parë, se nuk ka rrugë tjetër përveçse ta çlirojmë këtë aulë nga konflikti i interesit që ka me krimin, kriminelët dhe oligarkët. Këtë duhet ta bëjmë përmes miratimit të platformës opozitare për Shqipërinë ose duke ftuar vetë qytetarët këtu në këtë sallë të marrin në dorë fatet e tyre, sepse kjo nuk është më në dorën tonë. Një gjë dua t'ju garantoj, se duke nisur nga sot Partia Demokratike dhe opozita kanë një dhe vetëm një mision: t'u prijnë qytetarëve drejt të drejtës së tyre më legjitime, të bëhen zot të fateve të vendit, të bëhen zot të fateve të familjeve të tyre, të bëhen zot të fateve të fëmijëve të tyre, të bëhen zot të fateve të tyre dhe të bëhen zot të fateve të këtij parlamenti e të kësaj qeverie përmes një kryengritje demokratike popullore për t'i dhënë fund regjimit të këtij të marri psikik, që vjedh dhe shkatërron Shqipërinë. Kjo duhet të marrë fund një orë e më parë!

Gramoz Ruçi – Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste fjalën e ka zoti Rama.

Edi Rama – Lëreni doktorin sot, mos e ngacmoni, sepse ka hall!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Opozita largohet nga salla.)

Sali, ta qaj hallin për mesazhin që ke marrë, të vështirë e ke.

Po e nis fjalën time nga shprehja brutale dhe e neveritshme, këtu në këtë foltore, e kryetarit të Partisë Demokratike, i cili iu drejtua zonjave në podiumin e qeverisë, duke thënë me fjalë të pamenduara atë që është problemi i tij dhe i këtyre. Këta nuk kanë, të paktën për disa kohë, asnjë mundësi të hedhin baltë, zero, sepse kushdo që është bashkuar me ne në qeveri, duke ardhur nga të tjera drejtime, ka një karrierë profesionale, ka një integritet të padiskutueshëm dhe, njëkohësisht, mishëron atë që jemi ne, atë që Partia Socialiste ka qenë kohë më parë dhe atë që e ka bërë Partinë Socialiste thelbësisht të ndryshme nga këto partitë e tjera dhe që ka mundësuar ripërtëritjen e vazhdueshme të saj dhe të qenurisë së saj si një platformë për këdo që ka pasur diçka për të dhënë. Unë jam vetë këtu shprehje e kësaj mënyre të të qenit të Partisë Socialiste, që nuk kam ardhur nga rruga e partisë, por nga rruga e shoqërisë aktive, civile dhe urbane. Ndërkohë, duke parë përballë meje, jo vetëm që nuk jam i vetmi, por shumëkush këtu është si unë dhe të gjithë së bashku jemi Partia Socialiste, forca që ka lindur për të qenë në dispozicion të të gjithë atyre që duan të kontribuojnë për këtë vend dhe që u ka dhënë mundësinë profesionistëve, u ka dhënë mundësinë figurave publike, që kanë dashur të përfshihen në politikë, sikundër u ka dhënë mundësinë më të rinjve, në forumin e saj rinor, që të rriten e të bëhen të gjithë së bashku fytyra dhe forca e kësaj partie. Ne, jo vetëm që nuk kemi ndër mend të kompleksohemi, përkundrazi, jemi krenarë për këtë. Ajo që kemi bërë, ajo që po bëjmë dhe ajo që do të bëjmë gjithmonë është duke u hapur për të tjerët dhe duke u dhënë mundësi të tjerëve që Partinë Socialiste ta shohin si fuqinë e tyre të ndryshimit dhe t'i bashkohen për të rritur fuqinë tonë të përbashkët të ndryshimit.

Nga ana tjetër, është shumë e qartë që ne sot jemi më shumë dhe jemi më të fortë sesa një muaj më parë, sepse sot ne kemi shumë më tepër forca këtu në parlament dhe kemi shumë më tepër forca të shpërndara në territor, aty ku kemi nisur edhe një herë tjetër përgatitjet për një betejë, ku nuk diskutohet nëse ne do fitojmë apo jo, po ku diskutohet diçka tjetër, se sa shumë ne do ta shfrytëzojmë këtë fazë, për të bërë më

shumë, për të qenë më pranë njerëzve e për t'i përfaqësuar ata edhe më mirë, qoftë në nivel qendror (në parlament apo në qeveri), qoftë në nivelin vendor.

Natyrisht, nuk ka pasur më parë një mundësi për ata që protestojnë, që të dëgjohen e të respektohen, siç janë dëgjuar dhe janë respektuar protestuesit falë nesh.

Sot është 21 janar. Këta vranë tetë vjet më parë. Sot, vijnë këtu dhe natyrisht, janë akoma të karikuar nga ideja se drejtësia nuk do të vihet dhe mendojnë akoma se do të vazhdojnë ta pengojnë, ta ngatërrojnë dhe ta përmbysin reformën në drejtësi, e cila është pa kthim.

Është e vërtetë që ende 21 janari mbetet një plagë e hapur, e pahetuar dhe e pagjykuar deri në fund. Ende ata, të cilët duhet të përgjigjen përpara ligjit për 21 janarin, janë të pandëshkuar, por është po kaq e vërtetë që sot Shqipëria është ndryshe nga ç' ishte vjet.

Është po kaq e vërtetë që gjykatësit e 21 janarit sot janë rrugëve, nuk janë më gjykatës. E nëse sot janë rrugëve, nesër mund të përfundojnë prapa hekurave, sepse drejtësia e re nuk është që thjesht të pushojë nga puna ata, që janë të padenjë për të qenë gjykatës dhe prokurorë. Drejtësia e re është që ata, të cilët janë të padenjë dhe kanë llogari të hapura me drejtësinë, nesër të jenë të akuzuarit e drejtësisë.

Natyrisht, kush nga ne nuk do të donte që kjo çështje të ishte mbyllur dhe edhe dikush këtu të ishte prapa hekurave sot për ata të vrarë në bulevard? Unë i pari. Pikërisht pse ne nuk jemi uzurpatorë të pushteteve, por jemi reformatorë të shtetit; pikërisht pse ne nuk jemi ata që duam të kontrollojmë çdo gjë, por jemi ata që duam të vëmë kontrollin e ligjit mbi të gjithë, sot jemi ne ata që duhet të shtrëngojmë dhëmbët, të durojmë edhe dënglat e këtyre e të shtyjme përpara reformën në drejtësi dhe të gjitha reformat e tjera.

Nuk po flasim për të bërë një betejë, dy, tre, katër apo pesë. Ato i bëjmë dhe i fitojmë. Po flasim për të bërë një proces shtetndërtimi, që nuk është një proces i thjeshtë, ama është po kaq e sigurt që këta, sot kanë më shumë arsye sesa kishin një muaj më parë që të reflektojnë. Këta, sot janë edhe më të dobët sesa ishin një muaj më parë.

Ndërkohë, ne jemi më të fortë, sesa ishim një muaj më parë. A e dini pse? Pikërisht sepse

protesta e studentëve na dha mundësinë që të dëgjojmë, të reflektojmë e të reagojmë. Ndërkohë që protesta e studentëve këtyre u dha mesazhin: nuk ju shikojmë dot me sy!

Protesta e studentëve ne na drejtoi një kërkesë shumë të qartë: duam këtë dhe këto me radhë dhe i duam nga ju. Askush tjetër nuk i bën dot për ne.

Ndërkohë, këtyre, protesta e studentëve u tha se nuk ekzistojnë si alternativë. Prandaj, kur broçkullisin këtu e sjellin gjithmonë e më shumë gjuhën aty ku gjuha nuk mund të shkojë në një sistem demokratik, te dhuna, te konfrontimi, te përplasja. Kujtojnë se shqiptarët, të cilët kanë 1001 arsye që të kërkojnë më shumë nga ne, do të shkojnë pas berihait e do të shpresojnë te vezët e këtyre, apo te pilivesat mes tyre.

Siç e patë, të gjithë janë shumë të shqetësuar për atë që ne bëmë sot, për ndërprerjen e procedurave për partneritetin publik-privat në aksin Thumanë- Kashar. Janë shumë të shqetësuar, sepse është një hapësirë fiskale për një partneritet publik-privat goxha të shtrenjtë. Pra, është një volum parash i konsiderueshëm, të cilin ne kemi vendosur ta kalojmë për universitetin dhe për arsimin në tërësi, nëse ka më shumë hapësirë.

Çfarë do të thotë kjo? Kjo nuk do të thotë që paratë janë në buxhet sot. Se këta janë përveç të tjerave, edhe doktorë shkencash me tituj.

Parafolësja këtu, se nuk dua t'i përmend as emrin, është Doktore e Shkencave, por e vetmja shkencë që ajo njeh është shkenca e filxhanëve, për të parë fatin e për t'u thënë shqiptarëve që unë kam edhe pak muaj jetë. Unë nuk e di sa muaj jetë kam akoma, ose sa vite, por një gjë është e sigurt, që këta nuk vijnë më këtu dhe atje, sa të jetë Partia Socialiste e Shqipërisë (me mua ose pa mua).

Tani, "kazan", të lutem, mos jep lajmin që Edi Rama pohon: "Kam dhe pak mua jetë"!

Pakti për universitetin ka një komponent, infrastrukturën. Çfarë po bëjmë ne, që ta dëgjojnë edhe ata që jenë të interesuar? Ne kemi ngritur grupe të përbashkëta mes ministrive dhe universiteteve, sipas fushave dhe këto grupe të përbashkëta do të ndërtojnë, përveç të tjerave, të gjithë projektin për investimet, që lidhen me infrastrukturën. Këto projekte, të ndërtuara së bashku me universitetin, për investimet që lidhen me infrastrukturën do të bëhen bashkë e do të

jenë një program i qeverisë sonë për infrastrukturën e universiteteve, për kampusin që prezantuar apo për komponentët e tjerë infrastrukturorë në universitetet e tjera, program që ne do ta ofrojmë në bashkëpunim me sipërmarrjen. Patjetër, me partneritet publik-privat, por jo më për të bërë aksin Thumanë-Kashar, por për ta transformuar njëherë e përgjithmonë të gjithë infrastrukturën e universitetit. Nëse do të kemi hapësirë brenda këtij volumi, se është një volum i konsiderueshëm, do të përfshijë edhe infrastrukturën e sistemit parauniversitar.

Ata nuk e kuptojnë, por njerëzit e kuptojnë dhe njerëzit e dinë se kujt duhet t'i besojnë. Jo rastësisht njerëzit vazhdojnë e do të vazhdojnë të na besojnë, pavarësisht gabimeve, të metave, boshllëqeve dhe gjithçkaje që bie ndesh me pritshmëritë e tyre ndaj nesh. I kanë pritur nga ne të gjitha dhe menjëherë. Kjo nuk është e mundur.

Mbase mund të kishim bërë më shumë. Mbase mund të bëjmë më shumë sesa mendojmë se është e mundur të bëhet, por ajo që është plotësisht e sigurt, është se nuk duhet të merremi me këta. Ne nuk jemi si këta, por kur vijmë këtu, në këtë kazan, që është kazani më i madh i Shqipërisë, parlamenti i transformuar në kazan nga këta, ne dukemi si këta.

Sot është dënuar për shpifje nga gjykata dhe shiko se çfarë logjike ndjek, njësoj siç e kam parë me sytë e mi këtë tjetrin këtu, këtë *mister* TH-në, që kur doli para gjykatës, si një pulë, thoshte: "Ne nuk kemi gjë me këtë, por kështu na tha partia."

Kur e pyetën se ku i keni provat, u përgjigj: "Prova është partia, se ne i besojmë partisë e si do të mendojmë ne, që partia nuk thotë të vërtetën?!"

Ja, këto thoshte *mister* "Th-ja" atje.

Ndërkohë, ky tjetri dënohet nga gjykata për shpifje, pas një sulmi që i bënë kryetarit të Grupit Parlamentar të PS-së, duke e akuzuar konkretisht.

Çfarë thonë në gjykatë? Ai i çon në prokurori dhe u thotë: "Dakord, nëse unë jam i përfshirë në këtë veprimtari kriminale, ti sill një provë dhe unë vihem në dispozicion të drejtësisë."

"Provat i kemi parë në gazeta", thanë. E keni dëgjuar ju këtë? "Kemi lexuar gazetën dhe i kemi thënë".

Pa pikën e turp, kur dënohen për shpifje, thonë: "Na dënoi gjykata e kapur nga frika e vetingut, të cilës i bëhet presion". Po çfarë presioni? "Gjykata duhet të priste fundin e hetimit, sepse kushedi, ajo që kemi thënë ne, është e vërtetë."

Ky shpifës nuk e ka të parën këtë. Sot pyeta ekipin, që merret me shpifjet. Nja dyzet e ca, ky dhe ky tjetri këtu, që ishte shumë i mërzhitur. Ka një hall shumë të madh ky tjetri, ky i madhi.

Unë nuk e ndaj dot me ju, prandaj ishte sot kështu, me kokën të futur brenda supeve. Ka një hall të madh, shumë të madh dhe s'fliste sot. E patë?

Me këta të dy, nja 40 procese i kam unë dhe nuk i kam nga këto, që bënë Taulanti, që shkon në prokurori dhe pastaj përfundon me 500 mijë lekë të vjetra, por janë gjyqe civile për fondin për arsimin.

Xhemal, të gjithë fshatrat e katundeve tona do të bëhen me kompjuterë vetëm nga ky i madhi këtu dhe nga i biri atje, që pa pikën e turp kthehet dhe thotë: "Kush jeni ju, nga erdhët?" Po ky, kush është? Nga erdhi, që akoma s'dihet nëse e ka mbaruar apo nuk e ka mbaruar shkollën?

E fundit. Sot që flasim, nga viti i kaluar janë afro gjysmë milioni shqiptarë, që nuk kanë mundësi ta bëjnë *check up*-in në Amsterdam, në Vjenë, siç i bëjnë këta të dy, i vogli dhe i madhi. Është bërë falas këtu, me standarde të njëjta si në Vjenë dhe në Amsterdam, me laboratorë ultramodernë dhe me kushte optimale.

Çfarë kanë këta me *check up*-in? Pse i shqetëson këta?

Dakord, po e ndalojmë partneritetin dhe nuk po e bëjmë më dhe gjysmë milion njerëzve, që e bëjnë çdo vit e që numri i tyre po shkon duke u rritur, sepse njerëzit janë shumë më të mençur sesa i kujtojnë këta dhe po e shfrytëzojnë gjithmonë e më tepër këtë mundësi, çfarë do t'u themi? Do t'u themi atë që u thoshin këta: "shkoni bëjeni *check up*-in me 81 mijë lekë të vjetër ose kurrë mos e bëfshi!"

Check up-in e paguan shteti. Sigurisht, e paguan shteti dhe shërbimin e garanton një sipërmartje, e cila ka investuar para për laboratorët, për makinat, për qendrat, për të gjithë stafin dhe për trajnimin e qindra njerëzve, por shteti paguan analizat e gjysmë milion njerëzve. Para pak ditësh një tjetër paketë falas u bë për lentet e syve për pensionistët, në radhë të

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 21 JANAR 2019

parë. Një milionë e gjysmë paguan shteti, por shërbimi bëhet në publik. Shërbimi i *check up-it* bëhet në të gjithë infrastrukturën publike, pra nuk fusin dorën në xhep shqiptarët. Çfarë i shqetëson këta atëherë? Se këta kanë vetëm vjedhjen në gojë.

Ky thotë se këta njerëz këtu (ministrat) i sollën oligarkët, ndërkohë që thotë se nuk i njeh kush janë. E dini pse? Sepse dihet botërisht se kush ia bën këtij edhe listat e deputetëve, edhe kryesinë e Partisë Demokratike. Vijnë flasin e qajnë hallin e Partisë Socialiste! E kush ia qan hallin?! Po Partia Demokratike ku është? Na vjen keq, thotë, se është gjithë kjo parti e madhe. Tamam si atëherë, kur Shqipëria i qante hallin Amerikës, edhe këta qajnë hallin tonë!

E ka bërë Partinë Demokratike “kashtë dhe koqe” dhe vjen këtu e qan hallin e Partisë Socialiste. Ky e shkatërroi në një formë që nuk e di. Asnjë nga ne, jam i sigurt, edhe Taulantit po t’i kishte thënë merre, shkruaje si do ti që ta shkatërrosh PD-në, nuk e bënte dot siç e bëri Luli. Personalisht Taulant Balla, njeriu i “të gjitha të zezave”, nuk ia bënte dot atë të zezë që i bëri Luli Partisë Demokratike, dhe vjen e qan hallin tonë këtu!?

Së fundi, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se beteja jonë nuk është me këta. Sa më shumë përplasemi ne me këta, aq më shumë dukemi si këta. E ne nuk e meritojmë të dukemi si këta. Ne nuk jemi më të mirët, por më të mirë se ne nuk ka. Sa më shumë të kuptojmë që beteja jonë është me shumë e shumë probleme, që beteja jonë është sesi ne duhet të jemi fuqia e njerëzve në çdo hap e në çdo veprim që bëjmë, aq më shumë ne do të marrim atë që na takon, jo për vete, por për vendin; jo për vete, por për qytetet tona.

Ne nuk i duam qytetet dhe bashkitë për vete. Ne e duam fuqinë nga njerëzit për bashkitë dhe qytetet tona. E njëjta gjë është edhe për vendin. Unë jam i bindur që kjo është rruga jonë. Sa më pak të merremi me këta, aq më pak do të dukemi si këta. Sa më shumë të merremi me problemet e me njerëzit, aq më shumë njerzillëk do të ketë qeverisja jonë. Qeverisja jonë nuk ka problem asgjë tjetër më shumë, se sa të jetë e njerëzishme në çdo hap dhe në çdo minutë, të ketë kapacitetin të dëgjojë në çdo hap dhe në çdo minutë.

Këta le të merren me *Instagramin* tim, se aty të paktën janë të vetmet momente ku mund të duken si njerëz.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Rama!

Vazhdojmë me çështjet e rendit të ditës, të cilat janë:

Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 20 dhe 21 dhjetor të vitit 2018, si dhe i procesverbalit të datës 16 janar të vitit 2019;

Njoftimi për projektligjet e depozituara në Kuvend.

Miratimi i draftprogramit të punës së Kuvendit për periudhën 21 janar deri më 1 mars të vitit 2019.

Miratimi i draftkalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar deri më 8 shkurt të vitit 2019.

Paraqitja në Kuvend e kalendarit të raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për veprimtarinë e tyre të vitit 2018.

Projektvendimi për disa ndryshime në vendimin nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”.

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit””;

Dekreti nr. 11061, datë 18.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Ditmir Bushati, Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme”.

Dekreti nr. 11062, datë 18.01.2019 “Për emërimin e Kryeministrit, zoti Edi Rama, edhe Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

A ka vërejtje për procesverbalet e datave 20 dhe 21 dhjetor të vitit 2018 dhe 16 janar të vitit 2019? Nuk ka.

Kush është dakord?

Miratohet.

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave janë depozituar tetë projektligje dhe një akt normativ me fuqinë e ligjit.

Nga deputetët është depozituar një projektligj dhe një kërkesë për komision hetimor.

Nga Presidenti i Republikës janë depozituar dy dekrete për rishqyrtim ligjesh, bëhet fjalë për ligjin e kadastrës dhe ligjin për noterinë, si dhe

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 21 JANAR 2019

dekreti “Për propozimin e zotit Bahri Shaqiri, kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Materialet do t’i gjeni, si gjithnjë, në faqen zyrtare të Kuvendit.

Miratimi i draftprogramit dhe i draftkalendarit të Kuvendit. Ju njoftoj se ditën e martë u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi për draftprogramin e punës së Kuvendit dhe për kalendarin 3-javor të periudhës në vijim. Në Konferencë nuk pati konsensus. Për pasojë, në mbështetje të nenit 26, pika 6, dhe të nenit 27, pika 4, të Rregullores, i hedhim në votim.

Kush është dakord?

Miratohej draftprogrami dhe draftkalendarit, të cilët do t’i gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

Kalendarin e raportimeve të organeve kushtetuese e keni përpara, në tavolinë. Edhe këtë material do ta gjeni në internet, në faqen zyrtare të Kuvendit.

Vazhdojmë me dekretin nr. 11061, datë 18.01. 2019 “Për shkarkim ministri”. Propozohet nga Kryeministri dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, zoti Ditmir Bushati, Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme.

Procedura e votimit me elektronikë, votim i hapur, një votim me shumicë absolute votash.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

78 deputetë janë prezentë.

Hapet votimi për dekretin nr. 11061, datë 18.01.2019 “Për shkarkim ministri”. Me elektronikë, ju lutem!

Mbyllet votimi.

77 vota pro, 1 abstenim, asnjë kundër.

Miratohej.

Dekret nr. 11062, datë 18.01.2019 “Për emërimin e Kryeministrit, zotit Edi Rama, edhe Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme”. Zoti Rama propozohet nga Kryeministri dhe emërohet nga Presidenti i Republikës Kryeministër dhe Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

78 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohej.

Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar””. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të

Rregullores së Kuvendit, ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim. Konkretisht, deputeti Arben Ahmetaj propozohet kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat; deputeti Niko Peleshi propozohet kryetar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; deputetja Senida Mesi propozohet zëvendëskryetare e Komisionit për Integrimin Europian; deputetja Klodiana Spahiu propozohet zëvendëskryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë; deputeti Arben Kamami propozohet sekretar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Hapet votimi. Një votim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

78 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohej.

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar””. Deputeti Damian Gjijnuri propozohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; deputeti Arben Pëllumbi largohet nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe propozohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; deputetja Mirela Kumbaro propozohet anëtare në Komisionin për Integrimin Europian; deputetja Senida Mesi dhe deputeti Vullnet Sinaj propozohen anëtarë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat; deputetët Alket Hyseni, Ditmir Bushati dhe Reme Lalaj propozohen anëtarë në Komisionin për Politikën e Jashtme; deputetët Antoneta Dhima dhe Elena Xhina propozohen anëtare në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, deputetët Lindita Nikolla dhe Mirela Kumbaro propozohen anëtare të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik; deputetja Klotilda Bushka largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe propozohet anëtare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Deputeti Vullnet Sinaj largohet nga Komisioni i Sigurisë dhe deputeti Fatmir Velaj largohet nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 21 JANAR 2019

79 vota pro...

Nga doli kjo? Ka ardhur ndonjë deputet?

Projektvendim “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore”. Propozohet shtyrja e afatit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore edhe 1 muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

79 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 18:30)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**